

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Priština – Municipality of Prishtina	
---	--	---

Në bazë të nenit 21 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, nenit 18 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim, nenit 21, 22, 44, 45, 57 dhe 84 të Ligjit Nr. 05/L-03 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 17, pika "d" të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 15 pika "d" e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr. 06/2017 dt. 23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrërimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 nr.350/03-119076/22 dt.27.05.2022, të aplikuesve/pronarëve Jahir, Sadri, Ukshin, Naim Vitija, Bejtullah Berisha, Bahri Hoxha, Besnik Asllani, Milaim Hoti, Afrim Sejfiqaj, Dervish Muslijaj, Xhemajl Sollova, Elmaze, Donjeta, Donart, Diellza, dhe Florim Vitija nga Prishtina, dhe investitorit "EBA" SHPK, me seli në Rr. Fazli Grajçevci, Nr.17, Kati II, Prishtinë, të cilën e përfaqëson z. Astrit Çitaku nga Skënderaj, për miratimin e plotësimit dhe ndryshimit të kushteve ndërtimore të caktuara me aktin administrativ "Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore", 05 Nr.350/02-0245431/18, të dt.24.01.2019, përkatësisht për pranimin e palëve në procedurë, dhe ricaktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa shumë banesore dhe afariste "Andrra Rezidence 2" - Ndërtesa "Hyrja 1", "Hyrja 2" dhe "Hyrja 3", në kuadër të Bllokut urban "A-18", Tërësia "A" të Planit Rregullues "Prishtina e Re-Zona Qendër" në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datë 03.05.2023, merr këtë:

V E N D I M

**PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E AKTIT ADMINISTRATIV
"VENDIM PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE", 05 NR.350/02-0245431/18 DT.24.01.2019,
SHFUQIZIMIN E TIJ, PRANIMIN E PALËS NË PROCEDURË DHE RICAKTIMIN E KUSHTEVE
NDËRTIMORE**

I. MIRATOHET kërkesa, 05 Nr. 350/03-119076/22 dt. 27.05.2022, në emër të aplikuesve/pronarëve Jahir, Sadri, Ukshin, Naim Vitija, Bejtullah Berisha, Bahri Hoxha, Besnik Asllani, Milaim Hoti, Afrim Sejfiqaj, Dervish Muslijaj, Xhemajl Sollova, Elmaze, Donjeta, Donart, Diellza, dhe Florim Vitija nga Prishtina dhe investitorit "EBA" SHPK, me seli në Rr. Fazli Grajçevci, Nr.17, Kati II, Prishtinë, të cilën e përfaqëson z. Astrit Çitaku nga Skënderaj, për plotësimin dhe ndryshimin e kushteve ndërtimore të caktuara me aktin administrativ "Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore", 05 Nr. 350/02-0245431/18, të dt. 24.01.2019, përkatësisht shfuqizimin e tij, për pranimin e palëve në procedurë, dhe ricaktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor, për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa shumë banesore dhe afariste "Andrra Rezidence 2", në kuadër të Bllokut urban "A-18", Tërësia "A" të Planit Rregullues "Prishtina e Re-Zona Qendër" në Prishtinë.

II. SHFUQIZOHET akti administativ "Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore", 05 Nr. 350/02-0245431/18, të dt. 24.01.2019, i lëshuar nga kjo drejtori, në emër të aplikuesve/pronarëve Jahir, Sadri, Florian, Ukshin, Naim Vitija, Bejtulla Berisha, Bahri Hoxha dhe Besnik Asllani, nga Prishtina, me investitor "EBA" SHPK me seli në Prishtinë, me nr. të biznesit 810025470, përfaqësuar nga Astrit Çitaku, sipas kërkesës me referencë 05 Nr. 350/02-0245431/18 dt.09.10.2018, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e kompleksit "Andrra Residence", me ndërtesa shumëbanesore & afariste-"Hyrja 1" & "Hyrja 2", në kuadër të parcelës ndërtimore të bllokut urban "A-18", tërësia "A" të Planit Rregullues "Prishtina e Re -Zona Qendër" në Prishtinë, konkretisht në kuadër të kompleksit të formuar nga parcelat dhe pjesët e parcelave kadastrale, konkretisht në kuadër të parcelave kadastrale: nr.913-1, 914-8, 914-15 ZK Matičan, në pronësi private

dhe pjesë të parcelave kadastrale nr. 920-0 dhe 921-0 ZK Matičan, në pronësi publike, të propozuara për këmbim me pjesë të parcelës kadastrale nr.27-2 ZK Matičan, dhe kërkesa për caktimin e kushteve ndërtimore merret në rishqyrtim.

III. I RICAUTOHEN KUSHTET NDËRTIMORE aplikuesve/pronarëve Jahir, Sadri, Ukshin, Naim Vitija, Bejtullah Berisha, Bahri Hoxha, Besnik Asllani, Milaim Hoti, Afrim Sejfiqaj, Dervish Musliqaj, Xhemajl Sollova, Elmaze, Donjeta, Donart, Diellza, dhe Florim Vitija nga Prishtina dhe investitorit "EBA" SHPK, me seli në Rr. Fazli Grajçevci, Nr.17, Kati II, Prishtinë, me numër unik identifikues 810025470, të cilën e përfaqëson z. Astrit Çitaku nga Skënderaj, sipas kërkesës 05 Nr. 350/03-119076/22 dt. 27.05.2022, për plotësimin dhe ndryshimin e kushteve ndërtimore të caktuara me aktin administrativ "Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore", 05 Nr. 350/02-0245431/18, të dt. 24.01.2019, dhe pranimin e palëve në procedurë, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor për ndërtimin e kompleksit "Andrra Residence 2", përkatësisht shtimin e një etazhe-mbindërtimin e ndërtesës shumëbanesore & afariste – Ndërtesa "Hyrja 1" & "Hyrja 2" (të Faza e I-rë), me etazhitet -2B+S+P+8, dhe për ndërtimin e ndërtesës "Hyrja 3" (Faza e II-të), me etazhitet -2B+S+P+8, në kuadër të parcelës ndërtimore të bllokut urban "A-18" të Tërësisë Hapësinore "A" të Planit Rregullues "Prishtina e Re - Zona Qendër" në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës ndërtimore nr. 1664-0 ZK Matičan (Faza e I-rë) dhe parcelave kadastrale 913-2, 913-11, 914-12, 914-13, 914-14 ZK Matičan (Faza e II-të), dhe me trajtim edhe të parcelës nr. 27-24 ZK Matičan (në pronësi private), përmes këmbimit me parcelat kadastrale nr. 919-0, 920-2, 921-2 ZK Matičan, me pronar/posedues "P.SH. KK Prishtinë".

IV. GJENDJA EKZISTUESE e lokacionit/parcelave të lartcekura sipas gjendjes, kadastrale, pronësore, faktike & planifikimit urban, është:

- Numri, sipërfaqja, pronari & klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, janë:
 - nr.1664-0.....S=2745m²..... Jahir, Florim, Naim Vitija, Sadri, Ukshin Vitia, Bejtulla Berisha, Bahri Hoxha dhe Besnik Asllani..... "Tokë ndërtimore-Truall";
 - nr. 913-2.....S=1234m².....Xhemajl Sollova....."Arë e klasit 4";
 - nr. 913-11.....S=351m².....Elmaze Sadiku-Vitija, Donjeta, Donart, Florim dhe Diellza Vitija, Ukshin dhe Sadri Vitia....."Arë e klasit 4";
 - nr. 914-12.....S=200m².....Milaim Hoti....."Arë e klasit 6";
 - nr. 914-13.....S=175m².....Afrim Sejfiqaj....."Arë e klasit 6";
 - nr. 914-14.....S=175m².....Dervish Musliqaj....."Arë e klasit 6";
 - nr. 27-24.....S=565m² (nga totali S=2166m²)... Bahri Hoxha, Besnik Asllani;....."Arë e klasit 4";

Sipërfaqja totale në pronësi private S=2700 m²;

- nr. 919-0.....S=162m² (nga totali S=2463m²)..... P.Sh.K Komunal....."Arë e klasit 6";
- nr. 920-2.....S=189m² (nga totali S=703m²)..... P.Sh.K Komunal....."Arë e klasit 6";
- nr. 921-2.....S=214m² (nga totali S=3260m²)..... P.Sh.K Komunal....."Arë e klasit 6";

Totali i sipërfaqeve të parcelave në pronësi komunale S=565m².

- E drejta pronësore - juridike e parcelave të lartcekura, është private, në bazë të kopjes së planit dhe certifikatës së njësisë kadastrale;
- Në kuadër të parcelave kadastrale të lartcekura ka ndërtime ekzistuese –ndërtesa /shtëpi individuale të banimit, dhe atë si në vijim:
 - Nr. 1664-0, janë të ndërtuara ndërtesat e banimit në bashkëpronësi -"Hyrja 1" dhe "Hyrja 2", me etazhitet 2B+S+P+7, të ndërtuara bazuar në aktin administrativ "Vendim për lejimin e ndërtimit", 05 Nr. 351/02-298095/19 dt. 30.04.2020;
 - nr. 913-2/ një ndërtesë P+2;
 - nr.914-14/ një ndërtesë B+P+1;
 - nr.914-13/ një ndërtesë B+P;
 - nr.914-12/ një ndërtesë B+P+2;
 - nr.913-11/ nuk ka ndërtesë;
- Terreni ka pjerrtësi /disnivel nga drejtimi juglindje –veriperëndim, me nivel ~6m, sipas incizimit gjeodezik të prezantuar nga gjeodeti i licencuar Xhavit Gorçaj, me numër licence 23;
- Qasja në parcelat kadastrale të lartcekura shtrihen përgjatë Rr. "Malush Kosova" dhe Rr. "Mahmut Bakalli", njëkohësisht këto rrugë janë planifikuar me zgjerim sipas Planit Rregullues "Prishtina e Re - Zona Qendër";

- Pjesë të parcelave kadastrale nr. 919-0, nr. 920-2 dhe nr. 921-2, ZK Matëan, në pronësi P.Sh.K Komunal, me sipërfaqe prej $S=162+189+214=565m^2$, përfshihen brenda vijës rregulluese të bllokut urban "A-18", dhe të njëjtat janë propozuar nga pronarët dhe investitori, që të këmben me pjesën e parcelës kadastrale nr.27-24 ZK Matëan në pronësi private, me sipërfaqe prej $S=565m^2$;

- Në hapësirën e përfshirë në diametër prej 50m ka ndërtesa ekzistuese, kryesisht ndërtesa në bashkëpronësi, shtëpi individuale banimore, ndërtesa ndihmëse, etj.

V. KUSHTET NDËRTIMORE për hartimin e dokumentacionit ndërtimor-projektit kryesor, për rregullimin e hapësirës dhe realizimin-ndërtimin e kompleksit të ndërtesave shumëbanesore me afarizëm, në kuadër të Bllokut urban "A-18", Tërësia "A" të Planit Rregullues "Prishtina e Re-Zona Qendër" në Prishtinë, bazuar në parametrat urban të planit janë:

- Parcelat dhe pjesë të parcelave kadastrale me sipërfaqet e trajtuara, për realizimin e ndërtesave shumë banesore dhe afariste, konkretisht parcelat kadastrale të përfshira – të trajtuara brenda vijës rregulluese, për "Faza I" dhe "Faza II", janë:

- nr. 1664-0, me $S=2745m^2$,
- nr. 913-2, me $S=1234m^2$;
- nr. 913-11, me $S=351m^2$;
- nr. 914-12, me $S=200m^2$;
- nr. 914-13, me $S=175m^2$;
- nr. 914-14, me $S=175m^2$;
- nr. 919-0, me $S=162m^2$;
- nr. 920-2, me $S=189m^2$;
- nr. 921-2, me $S=214m^2$;

Sipërfaqe totale $S=5445m^2$;

- Parcelat dhe pjesë të parcelave kadastrale me sipërfaqet e trajtuara, për realizimin e ndërtesave shumë banesore me afarizëm, konkretisht parcelat kadastrale të përfshira –të trajtuara me këmbim, jashtë vijës rregulluese, janë:

- nr.1664-0, $S=0.00m^2$;
- nr. 913-2, $S=0.00m^2$;
- nr. 913-11, $S=0.00m^2$;
- nr. 914-12, $S=0.00m^2$;
- nr. 914-13, $S=0.00m^2$;
- nr. 914-14, $S=0.00m^2$;
- nr. 919-0, $S=0.00m^2$ (nga pjesa $S=162m^2$);
- nr. 920-2, $S=0.00m^2$ (nga pjesa $S=189m^2$);
- nr. 921-2, $S=0.00m^2$ (nga pjesa $S=214m^2$);
- nr. 27-24, $S=565m^2$, (nga totali $S=2166m^2$);

Sipërfaqe totale $S=565m^2$.

- Sipërfaqja e parcelës kadastrale me nr.27-24, ZK Matëan me $S=565m^2$, jashtë vijës rregulluese, është propozuar për trajtim me këmbim, sipas nenit 25 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019).

- Parcela kadastrale me nr. 1664-0, ZK Matëan, me sipërfaqe të përgjithshme $S=2745 m^2$, është formuar pas bashkimit dhe ndarjes së parcelave kadastrale, nr. 913-1, 914-8, 914-15 ZK Matëan, në pronësi private dhe pjesë të parcelave kadastrale nr. 920-0 dhe 921-0 ZK Matëan, në pronësi komunale (të trajtuara përmes këmbimit me parcelën kadastrale nr. 27-2 ZK Matëan), të përfshira brenda vijës rregulluese, bazuar në aktin administrativ "Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore", 05 Nr. 350/02-0245431/18, të dt. 24.01.2019;

- Me këto kushte ndërtimore në kuadër të parcelës ndërtimore, planifikohet të realizohen /ndërtohen ndërtesat shumë banesore dhe afariste, në bllokun urban "A-18", Tërësia "A", me sipërfaqe ndërtimore, shtrirje dhe etazhitet, sipas kalkulimeve dhe projekt propozimit, si në vijim:

Kompleksi "Andrra Rezidence 2" me ndërtesa shumë banesore & afariste –

Ndërtesa: "Hyrja 1", "Hyrja 2", "Hyrja 3".

Faza I-rë

Ndërtesa "Hyrja 1" + Ndërtesa "Hyrja 2"- me etazhitet 2B+S+P+7,

S=11,940.70m²/ 8,218.80m² mbi tokë + 3,721.90m² nën tokë/ (ndërtesa ekzistuese, të miratuar për ndërtim sipas "Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore", 05 Nr. 350/02-0245431/18, të dt. 24.01.2019, dhe "Vendim për lejimin e ndërtimit", 05 Nr. 351/02-298095/19 dt.30.04.2020);

Te Ndërtesa "Hyrja 1" + Ndërtesa "Hyrja 2", shtohet etazhitet në -2B+S+P+8, me sipërfaqe:

S=580.00 m²/ 580.00 m² mbi tokë + 0.00 m² nën tokë/

Faza II-të

Ndërtesa "Hyrja 3"-me etazhitet -2B+S+P+8,

S=12,050.80m² / 7,536.20m² mbi tokë + 4,514.60m² nën tokë/

Totali i sipërfaqeve ndërtimore të miratuara për Faza I,

S= 12,520.70m²/ 8,798.80m² mbi tokë+ 3,721.90m² nën tokë /

Totali i sipërfaqeve ndërtimore të miratuara për Faza II:

S=12,050.80 m²/8,116.2m² mbi tokë+ 4,514.6m² nën tokë/

Totali i sipërfaqeve ndërtimore të projektuara për Faza I dhe Faza II:

S=24,571.50 m²/ 16,335.00 m² mbi tokë+ 8,236.50 m² nën tokë/

- Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesave të kompleksit, të jetë për banim shumë banesor & afarizëm dhe me hapësira përcjellëse, si: kthina teknike, depo dhe hapësira garazhesh etj. (sipas projekt propozimit);
- Etazhiteti maksimal për Bllokun urban "A-18" Tërësia "A" të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër", është max. $V \div VIII$ etazhe mbi tokë (sipas projekt propozimit etazhiteti maksimal është -2B+S+P+8);
- Koeficienti i shfrytëzimit i parcelës ndërtimore / parcelave kadastrale të bashkuara në kompleks (ISHP), për vendosjen e ndërtesave në bazë-gabarit të përdhësos ose suteranit, lejohet max.40%, kurse për etazhet e banimit është max.30%;

Kompleksi "Andrra Rezidence 2" me ndërtesë shumë banesore & afariste –

Ndërtesat: "Hyrja 1", "Hyrja 2", "Hyrja 3".

S=5,445 x 0.4 =2178.00m²/sipas planit rregullues/

S=1,827.70 m² /shputa e ndërtesave – Ndërtesat: "Hyrja 1", "Hyrja 2", "Hyrja 3";

S=1,827.70 m² / sipas projekt propozimit /

- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore (ISHPN), sipas grupeve-fazave, për vendosjen e ndërtesës në bazë - gabarit të bodrumit është max.60%, bazuar në kriteret e planit rregullues dhe paragrafit II. pika 1. të Vendimit 01nr.031 – 185481 dt.14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, është:

S=5,445 x 0.6=3267.00m²/ sipas planit rregullues & vendimit /,

S=3,259.70 m²/ shputa e ndërtesave – Ndërtesat: "Hyrja 1", "Hyrja 2", "Hyrja 3"/

S=3,259.70m² / sipas projekt propozimit /

- Në kuadër të kompleksit të planifikohen edhe hapësira me sipërfaqe gjelbëruese (ISGJ) min.40%, me gjelbërim të lartë & të ultë, dhe të organizuara për sport & rekreacion. Sipërfaqet gjelbëruese, sipas kalkulimeve dhe projekt propozimit, për kompleksin është:

S=5,445 x 0.4=2178.00m² / sipas planit rregullues /

S=2178.00m² / sipërfaqe gjelbëruese e trajtuar për Ndërtesat: "Hyrja 1", "Hyrja 2", "Hyrja 3"/

S=1917.3m² / sipas projekt propozimit/

- Koeficienti i ndërtimit (ISPN) sipas tipologjisë "D" të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër" është max. 3.0.

Trajtimi i sipërfaqeve ndërtimore për etazhet ndërtimore do të bëhet – llogaritet, si në vijim: **100%** për etazhet mbi kuotën ± 0.00 , **50%** për etazhet me vëllim mbi **51%** apo së paku njëra ballore mbi nivelin e tokës – *suteren* dhe **0%** për etazhet e nëntokës – *bodrum*, dhe kjo sipërfaqe është:

$S = 5,445 \times 3.0 = 16,335.00 \text{ m}^2$ / sipas PRRU për parcelë ndërtimore /

$S = 16,335.00 \text{ m}^2$ / sipas projekt propozimit konceptual, duke përfshirë edhe sipërfaqen ndërtimore për parcelat kadastrale të propozuara për këmbim/;

- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, protokolluar me numrin 01nr.031-185481 dt. 14.08.2016, për shkaqe të kursimit dhe efijencës së energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;
- Bazuar në kriteret e planit rregullues, distanca minimale ballore në mes të ndërtesave të jetë $1.0 \times H$ (ku H, është lartësia mbi tokë e ndërtesës), kurse e ndërtesës me kufirin e parcelës fqinje $0.5 \times H$ ose min. 7m, ku distanca prej 7.0 m vlen edhe në rastet kur në atë fasadë nuk ka hapje – ndriçim primar për hapësirat e banimit (*dhoma dite, fjetje, pune, tryezari, korridore të banesave, etj*); Distanca në mes të ndërtesave (shumë banesore apo afariste) të fasadat e kombinuara (njëra ndërtesë fasadë ballore, kurse tjetra ndërtesë fasadë anësore) lejohet që distanca $0.6 \times H$;
- Ngritja e nivelit të përdhës nga niveli i terrenit- trotuarit të ndërtesës, lejohet max. 1.2 m;
- Qasjet në komplekse të jenë nga rrugët e planifikuara në mes Blloqeve urbane "A18 " ;
- Në kuadër të kompleksit të parashihen edhe VP e jashtme, shtigjet, trotualet kënde të lojërave për fëmijë, terrene sportive, mobiluar urban, etj.;
- Për çdo njësi banesore-rezidenciale të planifikohet 1.2 VP/një njësi banesore, kurse për pjesët afariste të ndërtesës, varësisht prej destinimit, të parashihen VP për çdo $1000 \text{ m}^2/40$ VP për shitore, banka, posta dhe të ngjashme, për çdo $1000 \text{ m}^2/20$ VP për administratë, për çdo $1000 \text{ m}^2/50$ VP për ndërtesa hoteliere, për çdo $1000 \text{ m}^2/30$ VP për ndërtesa kulturore dhe përmbajtje publike, si dhe për salla poli funksionale 20 ulëse / 1 VP;
- Në kuadër të kompleksit të parashihet hapësira për grumbullimin dhe vendosjen e mbeturinave;
- Si dhe aplikimi i të gjithave kushteve tjera urbane & arkitektonike të përcaktuar në kriteret & parametrat urban të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër";
- Arkitektura-dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të efijencës së energjisë, dhe ti përshtatet ambientit për rreth;

V. NDARJA / parcelimi i parcelave kadastrale, nr. 919-0, 920-2, 921-2, ZK Matigan, të bëhet sipas vijës rregulluese të planit rregullues dhe sipas manualit të punuar nga gjeometri i licencuar Xhavit Gorçaj nga Prishtina me licencë nr.23.

Kjo drejtori jep PËLQIM për ndarjen e parcelave të lartcekura, sipas Planit të situacionit - "zgjidhja urbane", "*Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01*", punuar nga kjo drejtori dhe manualit të ndarjes punuar nga gjeometri i licencuar. Procedura e ndarjes / parcelimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Kjo procedurë të realizohet në fazën pas miratimit të kushteve ndërtimore dhe para aplikimit për leje ndërtimore në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarëve dhe investitorit, duke u bazuar edhe në Planin e situacionit - "zgjidhja urbane", "*Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01*", punuar nga kjo drejtori dhe Manualit për ndarje punuar nga gjeometri i licencuar Xhavit Gorçaj nga Prishtina me numër licence nr.23, e cila është pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore.

VI. BASHKIMI i parcelave dhe pjesëve të parcelave kadastrale, nr.1664-0, 913-11, 914-12, 914-13, 914-14, 913-2, 919-0, 920-2 dhe 921-2, ZK Matigan, do të realizohet sipas Parcelës ndërtimore dhe pas realizimit të procedurës së ndarjes, përcaktuar në paragrafin VII. të këtij vendimi, bazuar në Planin e situacionit – "zgjidhja urbane", Situacionit të parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga Planin Rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër" në Prishtinë, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01 dhe manuali i bashkimit punuar nga gjeometri i licencuar.

Andaj, drejtoria jep PËLQIM për bashkimin e parcelave të lartcekura, sipas Planit të situacionit - "zgjidhja urbane" & Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga PRR "Prishtina e Re – Zona Qendër" në Prishtinë, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01 dhe manualit për bashkim.

Procedura e bashkimit do të realizohet pas realizimit të procedurës së përshkruar si në paragrafin V. & VI. të vendimit të kushteve ndërtimore dhe bazuar në pëlqimin e përshkruar në këtë paragraf, e cila do të shërbejë si bazë për regjistrimin në operetën kadastrale, të këtyre ndryshimeve, dhe para aplikimit për leje ndërtimore në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, me kërkesë të pronarëve dhe investitorit, si dhe bazuar në Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga Plani Rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër" në Prishtinë, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01 dhe Manualin e ndarjes punuar nga gjeometri i licencuar Xhavit Gorçaj nga Prishtina me numër licence nr.23, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

VII. KËMBIMI i pjesës së parcelës kadastrale nr. 27-24, ZK Matiçan, në bashkëpronësi të Bahri Hoxha dhe Besnik Asllani, me sipërfaqen prej $S=565m^2$ (nga totali prej $S=2166m^2$), e shtrirë jashtë vijës rregulluese të bllokut urban, gjegjësisht e përfshirë në hapësirë publike/shkollë dhe gjelbërim, i planifikuar sipas Planit Rregullues "Mati 1" në Prishtinë, me pjesë të parcelave kadastrale nr. 919-0, 920-2 dhe 921-2, ZK Matiçan, me sipërfaqe prej $S=162 + 189 + 214 = 565m^2$, në pronësi të P.SH. KK Prishtinë, nga kërkesit/pronarët është propozuar të bëhet bazuar në Ligjin Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Andaj, kjo drejtori jep Pëlqim për këmbimin e parcelave të lartcekura, sipas Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore dhe manualit të ndarjes, punuar nga gjeodeti i licencuar. Procedura e këmbimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e përshkruar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e këmbimit do të realizohet, para aplikimit për leje ndërtimore në Drejtorinë e Pronës të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore, me kërkesë të pronarëve dhe investitorit, duke u bazuar në Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga Plani Rregullues në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01, punuar nga gjeodeti i kësaj drejtorie, dhe kjo është pjesë e këtij vendimi.

Mos zbatimi i kësaj procedure sipas këtij paragrafit, nga pronari & investitori, për arsye të ndryshme, obligon Drejtorinë e Urbanizmit, të rishikojë kushteve ndërtimore-revokimin e tyre.

VIII. KYCJA NË INFRASTRUKTURË - për marrjen e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina" aplikimi do të bëhet nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçe në rrjetet përkatëse, i dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) Mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin - adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për energji elektrike dhe ujësjellës).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçe nga "Termokos" - Ngrohësja e Qytetit sh. dhe PTK-ja.

IX. DOKUMENTACIONI NDËRTIMOR - projekti kryesor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, "Udhëzimit Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënim për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", "Rregullores mbi normat minimale teknike për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi", të MMPH nr. 0/2016 dt. 04.11.2016, "Udhëzimit Administrativ MMPH-së 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor", bazuar në UA nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për

qasjen e personave me aftësi të kufizuara, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Situacionin - planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m², me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin - planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë;
- Situacionin - "zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesat e projektuara, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore - zejtare;
- Detajet e nevojshme në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë me përshkrimin e materialit të dyerve dhe dritareve, në përpjesë 1:50;
- Projektin e organizimit të kompleksit, me rrugë, shtigje, mobiliarin urban, etj;
- Projektin e strukturës së ndërtimit - llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionim dhe detaje të nevojshme;
- Projektin e instalimeve elektro – energjetike, me përcaktimin e vendit për kyçe në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafostacionit;
- Projektin e instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kyçe në rrjetin e qytetit;
- Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kyçe në rrjetin e qytetit;
- Elaborati i "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim", bazuar në Vendimin 01 nr. 035-174324 dt. 12.07.2016 e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Elaboratin e fizikës ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma;
- Elaboratin gjeomekanik në bazë të analizave në terrenit;

X. Dokumentacioni ndërtimor për MASAT E MBROJTËSE NGA ZJARRI të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet nga kjo drejtori në kompetencë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit të Komunës së Prishtinës, për sigurimin e "Deklaratë" për Masat e mbrojtjes nga zjarri.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Planin e mbrojtjes nga zjarri-elaboratin, të hartuar nga kompani apo individ i licencuar;
- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Situacionin-planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m², me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin-"zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Kushtet ndërtimore, të caktuara nga Drejtoria e Urbanizmit (kopje);
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të investitorit dhe të hartuesit të planit të mbrojtjes nga zjarri.

Dokumentacioni ndërtimor për Leje Mjedisore Komunale të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës, dhe aplikimi të bëhet në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtimore.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Raporti për Leje Mjedisore Komunale, në tre (3) kopje në formë të shkruar dhe një (1) në formë elektronike;
- Certifikatën për regjistrimin e biznesit;
- Certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit;

Kontratën për shfrytëzimin e parcelës, nëse parcela nuk është pronë e aplikuesit.

XI. MARRËVESHJA PËR INFRASTRUKTURË – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të “Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01 nr. 434/01–0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin / investitorin.

Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;
- Kontratën për bashkë investim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);
- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të kërkuarit/ve (bashkëpronarëve të parcelave & investitorit);

XII. PAGESA E KOMPENSIMIT PËR NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË TOKËS BUJQËSORE - meqenëse parcela kadastrale nr. 913-2, 913-11, 914-12, 914-13, 914-14, 919-0, 920-1 dhe nr.920-2, ZK Matičan, në bazë të certifikatës së njësisë kadastrale, janë të evidentuara me lloj të shfrytëzimit të parcelës-tokë bujqësore, me klasë të kualitetit “Arë e klasit 4”, “Arë e klasit 5” dhe “Arë e klasit 6”, kërkohet që paraprakisht të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, konformë nenit 11, 13 & 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8, 9 & 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do ti ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, gjegjësisht parcelës ndërtimore përcaktuar sipas Plani i situacionit – “zgjidhja urbane”, dhe e njëjta do të përfshijë sipërfaqen e parcelës ndërtimore, prej $S=1234+351+200+175+175+162+189+214=2700m^2$. Kjo sipërfaqe do të regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore,

Ky kompensim - pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore.

Pjesa e parcelës kadastral që shtrihen në hapësirë të planifikuar, t’ju ndërrohet destinimi i shfrytëzimit nga tokë bujqësore në destinim infrastrukturor – gjelbërim, konkretisht destinim i përcaktuar nga plani rregullues.

XIII. PAGESA E TAKSËS për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas “Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01nr.434/01 – 0094474/17 dt.24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor / projektin kryesor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

